



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .08.2025

MBLEDHJA Nr. 32,
Datë 07.08.2025, ora 10:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 07.08.2025, ora 10:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 32 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Bordit të ERE-s më datë 08.07.2025 dhe datë 17.07.2025.
2. Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë KESH sh.a. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës dhe regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për Hec Fierzë, Hec Koman dhe Hec Vau i Dejës.
3. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 108, datë 23.05.2025, “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë GSK sh.p.k. si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve”.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “POWER ENERGY” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “FIER THERMOELECTRIC” sh.a., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “AMEL ENERGY” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
7. Mbi kërkesën e shoqërisë “REBESOL” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.
8. Mbi kërkesën e shoqërisë “SAMASOL” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.

9. Mbi licencën për prodhimin e energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË” sh.a. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 101, datë 07.11.2014 dhe pagesën përkatëse të rregullimit.
10. Çështje të tjera.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI